

## **DAC\_FAL\_02: Ndarja e Plotë e Tregjeve të DAC**

**Përbajtja**

1. Hyrje.....	3
1.1. Qëllimi.....	3
1.2. Drejtar / Rregulluar nga .....	3
1.3. Mjetet dhe Protokollet e Komunikimit .....	3
1.4. Procedurat e shoqëruesse.....	3
2. Procedura.....	3
3.1. RASTI FD1: Rezultatet e ankandit të ditës në avancë nuk mund të përcaktohen në kohë, ose rezultatet paraprake të bashkimit të tregjeve nuk konfirmohen nga NEMO dhe/ose OST .....	5
3.1.1. Vështrim i përgjithshëm .....	5
3.1.2. Detajimi i procesit .....	7
3.2. RASTI FD2: Dërgimi me vonesë i Kapaciteteve Ndërkufitare.....	7
3.2.1. Vështrim i përgjithshëm .....	7
3.2.2. Detajimi i procesit .....	8
3.3. RASTI FD 3: Ndarja e Plotë e Tregjeve e njohur paraprakisht.....	9
3.3.1. Vështrim i përgjithshëm .....	9
3.3.2. Sqarimi i procesit .....	10
4. Gjendja përfundimtare .....	11
5. Investigimi dhe raportimi i incidentit.....	11

## **1. Hyrje**

Një Ndarje e Plotë e Tregjeve është një situatë ku nuk është e mundur, për një ditë të caktuar, të alokohen CZC-të nëpërmjet procesit të alokimit implicit (dmth. "Afati i fundit përfillimin e Komitetit të Incidencës" respektiv), ku është arritur një kufi kohor dhe Rezultatet e Bashkimit të Tregjeve nuk mund të publikohen përpara afatit Ndarjes së Plotë të Tregjeve.

### **1.1. Qëllimi**

Si vërejtje e përgjithshme, procedurat alternative synojnë të ofrojnë një kornizë të përbashkët në të cilën të gjitha procedurat lokale alternativer duhet të përputhen sipas rrrethanave.

Qëllimi i kësaj procedure është t'u ofrojë operatorëve një pasqyrë të orarit operativ dhe të punës përgatitore që duhet të kryhet në rast se Ndarja e Plotë e Tregjeve deklarohet nga Komiteti i Incidencës (IC).

Në përgjithësi, kur kalon afati i fundit përkatës për iniciimin e KI, aktivizohen procedurat alternative dhe paralelisht, nisin përgatitjet për Ndarjen e Plotë të Tregjeve .

Procedurat lokale përmenden vetëm për qëllime referimi, ndërsa procedurat e përbashkëta të DAC-së shpjegohen më në detaje.

### **1.2. Drejtuar / Rregulluar nga**

- Marrëveshja Operacionale e Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë (DACOA)
- Procedurat NEMO - Ofruesi i Shërbimit MC

### **1.3. Mjetet dhe Protokollet e Komunikimit**

- Sistemi i Lokal i Tregtimit i NEMO
- Sistemi IT i OST

### **1.4. Procedurat e shoqëruese**

Procedurat rezervë

- DAC\_BUP\_01: Dërgimi i kapaciteteve ndërkufitare dhe kufizimeve të alokimit
- DAC\_BUP\_02: Rezultatet përfundimtare të MC

Procedura të tjera shoqëruese:

- DAC\_FAL\_01: Menaxhimi i Incidenteve
- DAC\_OTH\_02: Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm

## **2. Procedura**

Në varësi të arsyes së shpalljes së Ndarjes së Plotë të Tregjeve, janë tre raste, secili prej tyre me afatin e tij specifik:

- Rasti FD1 - Rezultatet e ankandit të ditës në avancë nuk mund të përcaktohen në kohë, ose rezultatet paraprake të bashkimit të tregjeve nuk konfirmohen nga NEMO dhe/ose OST
- Rasti FD2 – Dërgimi me vonesë i Kapaciteteve Ndërkufitare

○ Rasti FD3 - Ndarja e Plotë e Tregjeve e njohur paraprakisht

Lidhur me rastin FD1, çështja kritike që çon në Ndarjen e Plotë të Tregjeve ndodh kur rezultatet e ankandit të ditës në avancë nuk mund të përcaktohen në kohë, ose rezultatet paraprake të bashkimit të tregjeve nuk konfirmohen nga NEMO dhe/ose OST-te. Në këtë rast, Ndarja e Plotë e Tregjeve do të deklarohet në orën [ ] ose më herët nëse Komiteti i Incidencës dakortëson unanimisht për ta bërë këtë. Të gjithë hapat e nevojshëm të komunikimit duhet të ekzekutohen përpara se të deklarohet Ndarja e Plotë e Tregjeve siç përshkruhet në DAC\_OTH\_02

Lidhur me rastin FD 2, çështja kritike që çon në Ndarjen e Plotë të Tregjeve ndodh gjatë fazës para bashkimit të tregjeve, në fazën e Kapaciteteve Ndërkufitare, siç përshkruhet në DAC\_BUP\_01 . Në këtë rast, Ndarja e Plotë e Tregjeve do të deklarohet në orën [ ] ose më herët nëse Komiteti i Incidencës dakortëson unanimisht për ta bërë këtë. Të gjithë hapat e nevojshëm të komunikimit duhet të ekzekutohen përpara se të deklarohet Ndarja e Plotë e Tregjeve siç përshkruhet në DAC\_OTH\_02.

Për sa i përket rastit FD 3, çështja kritike që çon në Ndarjen e Plotë të Tregjeve është tashmë e njohur paraprakisht sepse kjo çështje shkaktoi Ndarjen e Plotë të Tregjeve për sesionin e mëparshëm të bashkimit të tregjeve. Në këtë rast, Ndarja e Plotë e Tregjeve mund të deklarohet ose pasditen e ditës në avancë, ose gjatë sesonit ditor të bashkimit të tregjeve deri në orën 10:00 nëse Komiteti i Incidencës e konsideron çështjen si shumë të rëndë për t'u zgjidhur deri në afatin e rastit FD 2.

Në çdo rast, parimi i përgjithshëm është se të gjitha palët po bëjnë të gjitha përpjekjet e tyre më të mira për të shmangur Ndarjen e Tregjeve .

Meqenëse çdo rast përfshin një Afat të ndryshëm për Ndarjen e Plotë të Tregjeve, ka procedura/masa të ndryshme për të zgjidhur çështjet që lidhen me Rastin FD1 ose Rastin FD2 ose FD3. Kjo detajohet më tej në seksionet 2.1 dhe 2.2.

Në varësi të rastit të Ndarjes së Plotë të Tregjeve, duhet të kryhen veprimet e mëposhtme:

**1. Informimi i tregut apo të ketë një vonesë në publikimin e rezultateve**

(vetëm për rastin FD1)

Në orën e rregullt të publikimit ([ ]), nëse rezultatet e bashkimit të tregut nuk janë publikuar ende, mesazhi i komunikimit të jashtëm **ALPEX\_ExC\_02: Vonesa në Publikimin e Rezultateve të Tregut** i përcillet nga NEMO te OST-të dhe Anëtarët e Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02 , për t'i informuar se procesi është i vonuar.

**2. Informimi i tregut kur ekziston riku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve** (Rasti FD1, FD2 dhe FD3)

Rasti FD1: Tridhjetë minuta përpëra afatit përkatës të Ndarjes së Plotë të Tregjeve, mesazhi i komunikimit të jashtëm **ALPEX\_ExC\_03b: Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve u përcillet nga NEMO te OST-të dhe Anëtarët e Bursës** sipas procedurës DAC\_OTH\_02, duke i informuar ata për riskun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve.

OST-të u dërgojnë një mesazh Pjesëmarrësve të Tregut, duke i informuar ata në lidhje me proceset alternative dhe ndryshimin e afatit të njoftimit (Ankandi Shadow i organizuar nga CAO).

Rasti FD2: Pesëmbëdhjetë minuta përpëra afatit përkatës të Ndarjes së Plotë të Tregjeve, mesazhi i komunikimit të jashtëm **ALPEX\_ExC\_03b: Risku i Ndarjes së Plotë të**

Tregjeve u përcillet nga NEMO te OST-të dhe Anëtarët e Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02, duke i informuar ata për riskun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve.

OST-të u dërgojnë një mesazh Pjesëmarrësve të Tregut, duke i informuar ata në lidhje me proceset alternative dhe ndryshimin e afatit të njoftimit (Ankandi Shadow i organizuar nga CAO).

Rasti FD3: Njëzet minuta përpara afatit përkatës të Ndarjes së Plotë të Tregjeve, mesazhi i komunikimit të jashtëm **ALPEX\_ExC\_03b: Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve** u përcillet nga NEMO te OST-të dhe Anëtarët e Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02, duke i informuar ata për riskun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve.

OST-të u dërgojnë një mesazh Pjesëmarrësve të Tregut, duke i informuar ata në lidhje me proceset alternative dhe ndryshimin e afatit të njoftimit (Ankandi Shadow i organizuar nga CAO).

### **3. Informimi i tregut pasi të deklarohet Ndarja e Plotë e Tregjeve** (Rasti FD1, FD2 dhe FD3)

Në afatin përkatës të Ndarjes së Plotë të Tregjeve, në rast se çështja ende nuk është zgjidhur dhe rezultatet e bashkimit të tregjeve nuk janë konfirmuar ende nga një konfirmim paraprak global ose gjatë sesionit ditor të bashkimit të tregjeve, Komiteti i Incidencës deklaron Ndarjen e Plotë të Tregjeve. Një mesazh komunikimi i jashtëm (**ALPEX\_ExC\_04b: Ndarja e Plotë e Tregjeve** ose **ALPEX\_ExC\_05b: Ndarja e Plotë e Tregjeve e njohur paraprakisht**) u përcillet nga NEMO te OST-të, CAO dhe Anëtarët e Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02, duke i informuar ata se është deklaruar Ndarja e Plotë e Tregjeve.

Në rastin FD 1, nëse zbatohet, OST-të u dërgojnë një mesazh Pjesëmarrësve të Tregut, duke i informuar ata se afati i njoftimit është zgjatur. Përveç kësaj, rezultatet lokale alternative u dërgohen OST-ve (nëse është e aplikueshme) dhe Anëtarëve të Bursës dhe më pas publikohen në CAO. Synimi është publikimi menjëherë pas orës [REDACTED] dhe synimi për Ankandin Shadow me një afat absolut në orën [REDACTED].

Sipas procedurës, NEMO rihap librat e urdhëporosive, kryen llogaritjet lokale të çmimeve dhe publikon rezultatet në mënyrë të pavavarur.

Në varësi të Interkoneksionit/kufirit, mund të përdoren zgjidhjet e mëposhtme alternative:

- Ankandi Shadow nëpërmjet CAO.

#### **3.1. RASTI FD1: Rezultatet e ankandit të ditës në avancë nuk mund të përcaktohen në kohë, ose rezultatet paraprake të bashkimit të tregjeve nuk konfirmohen nga NEMO dhe/ose OST.**

##### **3.1.1. Vështrim i përgjithshëm**

Një Ndarje e Plotë e Tregjeve e njohur gjatë sesionit ditor të bashkimit të tregjeve do të deklarohet në rast se rezultatet e bashkimit të tregjeve nuk mund të konfirmohen nga Konfirmimi Paraprak Global nga NEMO ose janë refuzuar në procesin e Rezultateve Përfundimtare të MC për shkak të problemeve të zbuluara vetëm gjatë sesionit aktual të bashkimit të tregjeve.

Tabela e mëposhtme liston të gjithë hapat e kërkuar dhe afatet përkatëse të nevojshme për përgatitjen dhe ekzekutimin e Ndarjes së Plotë të Tregjeve për Rastin FD1.

#	Procesi	Afati i fundit	Nga	te	Mjeti
*	NEMO iniciacion Komitetin e Incidencës.	[REDACTED]	NEMO	Ofruesi i Shërbimit MC	[REDACTED]
1	Komunikimi i jashtëm ALPEX_ExC_02 -Vonesë në publikimin e rezultateve të bashkimit të tregjeve për t'i informuar ata se procesi është vonuar.	[REDACTED]	NEMO	OST dhe Anëtarët e Bursës	[REDACTED]
2	OST-të ftohen t'i bashkohen Klsë, nëse nuk janë ende në takimin e Kl.	[REDACTED]	NEMO	OST	[REDACTED]
3	Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX_ExC_03b - Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve për të informuar rrëth riskut të Ndarjes së Plotë të Tregjeve.	[REDACTED]	NEMO	OST-të dhe Anëtarët e Bursës dhe CAO	
*	(Nëse është e aplikueshme) OST-të informojnë Pjesëmarrësit e Tregut për proceset e alokimit alternative dhe ndryshimin e afatit të njoftimit.		OST	Pjesëmarrësit e Tregut	
*	(Nëse është e aplikueshme) ekzekutimi i një mekanizmi alternativ lokal i alokimit të kapaciteteve. CAO do të fillojë organizimin e Ankandit Shadow dhe do të informojë lidhur me të në Kl.				
4	Ndarja e Plotë e Tregjeve deklarohet nga Kl nëse rezultatet e bashkimit të tregjeve ende nuk janë publikuar.	[REDACTED]	Komiteti i Incidencës	NEMO OST	[REDACTED]
5	Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX_ExC_04b - Ndarje e Plotë e Tregjeve për të informuar se është deklaruar Ndarja e Plotë e Tregjeve.		NEMO	Pjesëmarrësit e Tregut, OST-ve	[REDACTED]
*	Ankandet lokale të NEMO zhvillohen sipas procedurave lokale.				
*	(Nëse është e aplikueshme) OST-të informojnë Pjesëmarrësit e Tregut se Ndarja e Plotë e Tregjeve është deklaruar dhe se afati i njoftimit është zgjatur.		OST	Pjesëmarrësit e Tregut	

NB: Hapat lokale janë të shënuar me gri dhe janë deklaruar këtu vetëm për qartësi dhe për të pasur pasqyrën e përgjithshme. Ato nuk do të detajohen në seksionin e detajimit të procesit.

### **3.1.2. Detajimi i procesit**

- 1) Komunikimi i jashtëm ALPEX \_ ExC\_02 - Vonesa në publikimin e rezultateve të bashkimit të tregjeve për të informuar se procesi është vonuar.**

Në orën e rregullt të publikimit ( [ ] ), nëse rezultatet e bashkimit të tregjeve nuk janë publikuar ende, një mesazh komunikimi i jashtëm *ALPEX\_ ExC\_02 - Vonesa në Publikimin e Rezultateve të Tregut* i përcillet nga NEMO te OST-të dhe Anëtarët e Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02 , për të informuar se procesi është i vonuar.

- 2) OST-të ftohen t'i bashkohen KI-së, nëse nuk janë ende në takimin e KI E shumta deri në orën [ ], nëse OST-të nuk janë ende në takimin e KI, NEMO dërgon mesazhin e komunikimit të brendshëm *ALPEX\_ InC\_01* sipas procedurës DAC\_OTH\_02 me qëllim që të informojë OST-të për incidentin që mund të çojë në Ndarjen e Plotë të Tregjeve dhe të ftojë ata t'i bashkohen KI-së sa më shpejt që të jetë e mundur.**

- 3) Mesazhi i komunikimit të jashtëm *ALPEX\_ExC\_03b - Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve* për të informuar rreth riskut të Ndarjes së Plotë të Tregjeve .**

Në orën [ ], nëse rezultatet e bashkimit të tregjeve nuk janë konfirmuar ende, një mesazh komunikimi i jashtëm *ALPEX\_ExC\_03b - Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve* përcillet nga NEMO te OST-të dhe Anëtarët e Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02, për të informuar për riskun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve.

Procesi i zgjidhjes së problemit vazhdon deri në Afatin e Ndarjes së Plotë të Tregjeve ( [ ] ).

- 4) Ndarja e Plotë e Tregjeve deklarohet nga KI nëse rezultatet e bashkimit të tregjeve ende nuk janë publikuar.**

Në orën [ ], nëse rezultatet e bashkimit të tregjeve ende nuk janë publikuar, Komiteti i Incidencës deklaron Ndarjen e Plotë të Tregjeve.

- 5) Mesazhi i komunikimit të jashtëm *ALPEX\_ExC\_04b - Ndarje e Plotë e Tregjeve* për të informuar se është deklaruar Ndarja e Plotë e Tregjeve .**

Në orën [ ], menjëherë pas deklarimit të Ndarjes së Plotë të Tregjeve në KI, NEMO dërgon një mesazh komunikimi të jashtëm *ALPEX\_ExC\_04b - Ndarje e Plotë e Tregjeve* te OST-të dhe Anëtarët e Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02, për të informuar për Ndarjen e Plotë të Tregjeve .

- 6) Ankandet e NEMO zhvillohen sipas procedurave lokale.**  
Pas dërgimit të komunikimit të tregut në lidhje me deklarimin e Ndarjes së Plotë të Tregjeve, NEMO duhet t'i referohet procedurave të tyre lokale të NEMO për kryerjen e ankandeve lokale të NEMO.

### **3.2. RASTI FD2: Dërgimi me vonesë i Kapaciteteve Ndërkufitarë**

#### **3.2.1. Vështrim i përgjithshëm**

Tabela më poshtë liston të gjithë hapat e kërkuar dhe afatet përkatëse të nevojshme për përgatitjen dhe ekzekutimin e Ndarjes së Plotë të Tregjeve për rastin FD2

#	Procesi	Afati i fundit	Nga	te	Mjeti
1	NEMO inicion Komitetin e Incidencës.	[REDACTED]	NEMO	Ofruesi i Shërbimeve MC dhe OST	[REDACTED]
2	Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX_ExC_03b - Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve për të informuar rrëth riskut të Ndarjes së Plotë të Tregjeve.	[REDACTED]	NEMO	OST-të dhe Anëtarët e Bursës dhe CAO	
*	(Nëse është e aplikueshme) OST-të informojnë Pjesëmarrësit e Tregut për proceset e alokimit alternative dhe ndryshimin e afatit të njoftimit.		OST	Pjesëmarrësit e Tregut	
*	(Nëse është e aplikueshme) ekzekutimi i një mekanizmi alternativ lokal i alokimit të kapaciteteve. CAO do të fillojë organizimin e Ankandit Shadow dhe do të informojë lidhur me të në KI.				
3	Ndarja e Plotë e Tregjeve deklarohet nga KI nëse nuk ka Kapacitete Ndërkufitare.	[REDACTED]	Komiteti i Incidencës	NEMO OST	
4	Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX_ExC_04b - Ndarje e Plotë e Tregjeve për të informuar se është deklaruar Ndarja e Plotë e Tregjeve .		NEMO	OST, Anëtarët e Bursës	
*	Ankandet lokale të NEMO zhvillohen sipas procedurave lokale.				
*	(Nëse është e aplikueshme) OST-të informojnë Pjesëmarrësit e Tregut se Ndarja e Plotë e Tregjeve është deklaruar dhe se afati i njoftimit është zgjatur.		OST	Pjesëmarrësit e Tregut	

### 3.2.2. Detajimi i procesit

- 1) OST-të ftohen t'i bashkohen KI-së, nëse nuk janë ende në takimin e KI E shumta deri në orën [REDACTED], NEMO dërgon mesazhin e komunikimit të brendshëm *ALPEX\_InC\_01* sipas procedurës DAC\_OTH\_02 në mënyrë që të informojë OST-të dhe ofruesin e Shërbimit MC për incidentin që mund të çojë në Ndarjen e Plotë të Tregjeve dhe t'i ftojë ata të bashkohen me KI-në sa më shpejt që të jetë e mundur.
- 2) Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX\_ExC\_03b - Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve për të informuar rrëth riskut të Ndarjes së Plotë të Tregjeve.

Në orën █, nëse Kapacitetet Ndërkufitare nuk janë dërguar ende, një mesazh komunikimi i jashtëm ALPEX\_ExC\_03b - Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve i përcillet nga NEMO te OST-ve dhe Anëtarëve të Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02, për të informuar në lidhje me riskun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve.

Procesi i zgjidhjes së problemit vazhdon deri në Afatin e Ndarjes së Plotë të Tregjeve (█).

- 3) Ndarja e Plotë e Tregjeve deklarohet nga KI nëse rezultatet e bashkimit të tregjeve nuk janë publikuar ende.

Në orën █, nëse Kapacitetet Ndërkufitare nuk janë dërguar ende, Komiteti i Incidencës deklaron Ndarjen e Plotë të Tregjeve .

- 4) Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX\_ExC\_04b - Ndarje e Plotë e Tregjeve për të informuar se është deklaruar Ndarja e Plotë e Tregjeve.

Në orën █, menjëherë pas deklarimit të Ndarjes së Plotë të Tregjeve në KI, NEMO dërgon një mesazh komunikimi të jashtëm ALPEX\_ExC\_04b - Ndarje e Plotë e Tregjeve tek OST dhe Anëtarët e Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02, për të informuar për Ndarjen e Plotë të Tregjeve.

- 5) Ankandet e NEMO zhvillohen sipas procedurave lokale.

Pas dërgimit të komunikimit të tregut për deklarimin e Ndarjes së Plotë të Tregjeve, NEMO duhet të zhvillojë ankandin lokal në treg të izoluar.

### 3.3. RASTI FD 3: Ndarja e Plotë e Tregjeve e njohur paraprakisht

#### 3.3.1. Vështrim i përgjithshëm

Tabela më poshtë liston të gjithë hapat e kërkuar dhe afatet përkatëse të nevojshme për përgatitjen dhe ekzekutimin e Ndarjes së Plotë të Tregjeve për Rastin FD3.

#	Procesi	Afati i fundit	Nga	te	Mjeti
1	Ndarja e Plotë e Tregjeve u deklarua për sesionin e mëparshëm të bashkimit të tregjeve				
2	Komiteti i Incidencës është inicuar për të vlerësuar riskun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve të njohur paraprakisht.	█	NEMO	OST	█
3	Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX_ExC_03b - Vonesa e mëtejshme e sesionit të bashkimit të tregjeve për të informuar në lidhje me riskun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve të njohur paraprakisht.	█	NEMO	OST dhe Anëtarët e Bursës	█

4	Ndarja e Plotë e Tregjeve e njojur paraprakisht deklarohet nga KI nëse çështja kritike nuk mund të zgjidhej.	[REDACTED]	Komiteti i Incidencës	OST NEMO	[REDACTED]
5	Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX_ExC_05b – Ndarje e Plotë e Tregjeve e njojur paraprakisht për të informuar se është deklaruar Ndarja e Plotë e Tregjeve.	[REDACTED]	NEMO	OST dhe Anëtarët e Bursës	[REDACTED]
*	Ankandet lokale të NEMO zhvillohen sipas procedurave lokale.				
*	(Nëse është e aplikueshme) OST-të informojnë Pjesëmarrësit e Tregut se është deklaruar Ndarja e Plotë e Tregjeve .	[REDACTED]	OST	Pjesëmarrësit e Tregut	[REDACTED]
*	(Nëse është e aplikueshme) Komitetet Organizative Lokale të Ndarjes së Tregjeve janë iniciuar për të monitoruar ankandet lokale.	[REDACTED]	NEMO	CAO	[REDACTED]
*	(Lokalisht) Mbyllja e librave të urdhëporosive të NEMO dhe zhvillimi i ankandeve lokale.	[REDACTED]	NEMO		[REDACTED]

NB: Hapat lokalë janë të shënuar me gri dhe janë deklaruar këtu vetëm për qartësi dhe për të pasur pasqyrën e përgjithshme. Ato nuk do të detajohen në kapitullin e Detajimit të Procesit.

### 3.3.2. Sqarimi i procesit

- 1) Ndarja e Plotë e Tregjeve është deklaruar për bashkimin e mëparshëm të tregjeve Një Ndarje e Plotë e Tregjeve e njojur paraprakisht mund të deklarohet vetëm në rast se sesioni i mëparshëm i bashkimit të tregjeve ka rezultuar me Ndarje të Plotë të Tregjeve dhe çështja kritike përkatëse nuk mund të zgjidhet e shumta deri në orën [REDACTED].
- 2) Komiteti i Incidencës është iniciuar për të vlerësuar riskun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve të njojur paraprakisht.

E shumta deri në orën [REDACTED], iniciohet Komiteti i Incidencës nga NEMO për të vlerësuar riskun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve të njojur paraprakisht.

Shënim: Ky është vetëm afati i fundit për iniciimin e KI. Nëse konsiderohet e dobishme, KI mund të iniciohet edhe pasdite edhe ditës në avancë.

NEMO përcjell mesazhin e komunikimit të brendshëm **ALPEX\_InC\_01** sipas procedurës DAC\_OTH\_02 për të informuar OST-të për incidentin që mund të çojë në Ndarjen e Plotë të Tregjeve të njojur paraprakisht dhe për t'i ftuar ata të bashkohen në KI sa më shpejt të jetë e mundur.

- 3) Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX\_ExC\_03b - Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve për të informuar lidhur me rrezikun e Ndarjes së Plotë të Tregjeve të njojur paraprakisht.**

Në orën █, nëse çështja kritike nuk është zgjidhur ende, një mesazh komunikimi i jashtëm *ALPEX\_ExC\_03b - Risku i Ndarjes së Plotë të Tregjeve* përcillet nga NEMO te OST-të dhe Pjesëmarrësve të Tregut sipas procedurës DAC\_OTH\_02, për të informuar për riskun e Ndarjes së Plotë e Tregjeve të njojur paraprakisht.

Procesi i zgjidhjes së problemit vazhdon deri në afatin e fundit për Ndarjen e Plotë të Tregjeve të njojur paraprakisht (ora █).

Komiteti i Incidencës mbledh informacion për të vlerësuar nëse çështja kritike është shumë e rëndë për t'u zgjidhur ose nëse mund të shmanget Ndarja e Plotë e Tregjeve e njojur paraprakisht.

- 4) Ndarja e Plotë e Tregjeve e njojur paraprakisht deklarohet nga KI nëse çështja kritike nuk mund të zgjidhej.**

Në orën █, nëse çështja kritike nuk është zgjidhur ende, Komiteti i Incidencës shpall Ndarjen e Plotë të Tregjeve të njojur paraprakisht.

- 5) Mesazhi i komunikimit të jashtëm ALPEX\_ExC\_05b - Ndarje e Plotë e Tregjeve e njojur paraprakisht për të informuar se është deklaruar Ndarja e Plotë e Tregjeve.**

Në orën █, menjëherë pas deklarimit të Ndarjes së Plotë të Tregjeve të njojur paraprakisht në KI, një mesazh komunikimi i jashtëm *ALPEX\_ExC\_04b - Ndarja e Plotë e Tregjeve e njojur paraprakisht* i përcillet nga NEMO te OST-të dhe Anëtarët e Bursës sipas procedurës DAC\_OTH\_02, për të informuar për Ndarjen e Plotë të Tregjeve të njojur paraprakisht.

#### **4. Gjendja përfundimtare**

Gjendja përfundimtare e procedurës së Ndarjes së Plotë të Tregjeve arrihet kur Ndarja e Plotë e Tregjeve deklarohet zyrtarisht duke informuar Anëtarët e Bursës ose në rast se çështja është zgjidhur përpara Afatit të Ndarjes së Plotë të Tregjeve.

#### **5. Investigimi dhe raportimi i incidentit**

Në rast se është organizuar Komiteti i Incidencës, NEMO është përgjegjës për plotësimin e Raportit të Komitetit të Incidencës dhe shpërndarjen e tij tek të gjitha palët e Komitetit të Incidencës, siç përshkruhet në procedurën DAC\_FAL\_01.